



**Republika e Kosovës  
Republika Kosovo/ Republic of Kosovo**

**Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor**

Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit / Kancelarija Glavnog Državnog Tužioca / Office of the Chief State Prosecutor

A.nr.42/2023

Datë: 14.02.2023

Prishtinë;

Ushtruesi i Detyrës së Kryeprokurori i Shtetit, në pajtim me nenin 1 paragrafi 1 dhe pika 1.1, 1.3, 1.5 dhe 1.6 të Ligjit nr.05/L-034 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-225 për Prokurorin e Shtetit, në zbatim të dispozitave të nenit 84 dhe 156 të Kodit të Procedurës Penale Nr.08/L-32 (KPP) për hedhjen e kallëzimit penal dhe pushimin e hetimeve, me qëllim të unifikimit të praktikave të punës në prokuroritë themelore, Prokurorinë Speciale (PSRK) dhe Prokurorinë e Apelit nxjerr këtë:

## **UDHËZIM**

### **Për procedurat e veprimit me rastin e shqyrtimit të ankesave kundër vendimeve të prokurorive themelore dhe PSRK-së në Prokurorinë e Apelit**

1. Në zbatim të nenit 84 dhe 156 të KPPK-së, viktima ose i dëmtuari brenda tetë (8) ditëve nga pranimi i njoftimit mund të paraqesë ankesë kundër:

- 1.1. Aktvendimit për hedhje të plotë ose të pjesërishtë të kallëzimit penal;
- 1.2. Aktvendimit për pushimin e plotë ose të pjesërishtë të hetimit;
- 1.3. Dështimit të prokurorit të Prokurorisë Themelore ose PSRK-së për të ndërmarrë veprime brenda afatit prej gjashtë (6) muajsh nga paraqitja e kallëzimit penal apo aktvendimit të Prokurorisë së Apelit me të cilin udhëzohet prokurori i Prokurorisë Themelore ose PSRK-së për ndërmarrjen e veprimeve shtesë;

2. Prokuroria themelore ose PSRK e regjistron ankesën e pranuar sa më shpejtë që të jetë e mundur, por jo më vonë se njëzetekatër (24) orë nga pranimi i saj dhe së bashku me dosjen e lëndës e procedon në Prokurorinë e Apelit. Në aktin përcjellës duhet të shënohet; data e dorëzimit të vendimit të viktima apo i dëmtuari si dhe data e pranimit të ankesës në prokurorinë themelore ose PSRK.

3. Para hedhjes së kallëzimit penal apo pushimit të hetimit, prokurori i shtetit konsultohet me kryeprokurorin e prokurorisë përkatëse dhe mban shënim zyrtar. Shënimi zyrtar nënshkruhet nga prokurori i shtetit dhe kryeprokurori.
4. Aktvendimi për hedhje të kallëzimit penal apo aktvendimi për pushim të hetimit merr formën e prerë vetëm pasi të ketë kaluar afati për paraqitje të ankesës nga viktimë ose i dëmtuari apo pasi Prokuroria e Apelit të ketë hedhur ose refuzuar ankesën e viktimës apo të dëmtuarit.
5. Prokurori i shtetit pa vonës e njofton gjyqtarin e procedurës paraprake për pushimin e hetimit. Gjithashtu, brenda tetë (8) ditësh pas pushimit të hetimit e njofton të pandehurin dhe mbrojtësin e tij si dhe palët tjera konform nenit 156, paragrafi 2 të KPPK-së. Në aktin e njoftimit të njëjtit njoftohen se ndaj këtij aktvendimi është e lejuar ankesa nga palët e autorizuara.
6. Prokuroria e Apelit trajton ankesën e parashtruar nga përfaqësuesi i viktimës apo të dëmtuarit ose mbrojtësi i viktimave si dhe ankesën e parashtruar nga përfaqësuesi ligjor i të dëmtuarit të mitur sikur të ishte parashtruar nga vetë viktimë ose i dëmtuari.
7. Prokurori i Apelit me rastin e shqyrtimit të ankesës nuk kufizohet vetëm në shkeljet e cituara nga pala në ankesë por ka mandat edhe sipas detyrës zyrtare të evitohet edhe shkeljet tjera që duhet të shqyrtohen sipas detyrës zyrtare siç janë shkeljet absolute të dispozitave të procedurës penale.
8. Nëse Prokuroria e Apelit e aprovon ankesën nga paragrafi 1 i këtij udhëzimi, prokurori i çështjes nga prokuroria themelore dhe PSRK-ja e njofton gjyqtarin e procedurës paraprake me vendimin e Prokurorisë së Apelit.
9. Aktvendimi për hedhje të kallëzimit penal apo pushim të hetimit nuk raportohet si lëndë e kryer para se vendimi të ketë marrë formën e prerë.
10. Për ankesat nga paragrafi 1, i këtij Udhëzuesi vendos prokurori individual i Prokurorisë së Apelit dhe brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga momenti i parashtrimit të ankesës e njofton parashtruesin e ankesës. Në rastet kur prokurori i Prokurorisë së Apelit e refuzon ankesën, parashtruesit të ankesës së bashku me njoftim ia dërgon edhe aktvendimin.
11. Prokuroria e Apelit mban regjistër të veçantë lidhur me regjistrimin dhe procedimin e ankesave të pranuar nga prokuroritë themelore dhe PSRK. Lënda e pranuar me ankesë në zyrën e regjistrimit të Prokurorisë së Apelit regjistrohet menjëherë në regjistrin përkatës dhe pa vonësë i dërgohet prokurorit kompetent të Prokurorisë së Apelit.



12. Prokurori i Prokurorisë së Apelit lidhur me ankesën nga paragrafi 1 i këtij Udhëzuesi vendos si në vijim:

11.1. E hedh poshtë ankesën në rastet kur është parashtruar nga personi i paautorizuar apo kur ankesa është paraqitur jashtë afatit;

11.2. E refuzon ankesën kur vlerëson se është e pabazuar dhe e konfirmon vendimin e prokurorit të shtetit;

11.3. E aprovon ankesën kur vlerëson se pretendimet ankimore janë të bazuara, anulon vendimin e ankimuar dhe udhëzon prokurorin e shtetit për ndërmarrjen e veprimeve shtesë.

13. Lidhur me ankesën nga paragrafi 8, i nenit 84, të KPPK-së, Prokuroria e Apelit nëse e aprovon ankesën atëherë e udhëzon prokurorin e prokurorisë themelore apo PSRK-së që të vendosë brenda afatit të caktuar kohor.

14. Udhëzimet e prokurorit të Prokurorisë së Apelit për prokurorin e prokurorisë themelore apo PSRK-së, kufizohen në ndërmarrjen e veprimeve konkrete shtesë hetimore apo procedurale.

15. Mos respektimi i këtij udhëzimi mund të konsiderohet si shkelje e Kodit të Etikës për prokurorë.

16. Ky udhëzim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Ushtuesi i Detyrës së Kryeprokurorit të Shtetit.

Ushtuesi i Detyrës së Kryeprokurorit të Shtetit  
**Besim Kelmendi**



Udhëzimi i dërgohet;

- Të gjithë Kryeprokurorëve dhe prokurorëve të shtetit;
- Arkivit të Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit (ZKPSH).

Obligohet administrata e ZKPSH-së që këtë udhëzim ta publikoj në ueb faqen e Prokurorit të Shtetit.